



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE E MBROJTJES SOCIALE
KLINIKA STOMATOLOGJIKE UNIVERSITARE
TIRANË

Tiranë, me 08.02.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje materiale laboratorit për nevoja të KSU” për vitin 2024

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

MALLRA, Kodet CVP: Instrumenta dentare 33130000-0

Mbajtëse mjetesh dhe pjesë mjetesh laboratorike 42671100-1, Freza dentare 33131142-4, Silikon në formë primare 245900000-6

VLERA E FONDIT LIMIT: 4 000 000 leke (pa tvsh), me burim financimi buxhet shteti 2024.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Klinika Stomatologjike Universitare Tirane**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të cëvanta për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë: Lidhur me kriteret e përgjithshme AK nuk i ndryshon pasi ato janë standarte të miratuara nga APP dhe gjejnë pasqyrim në shtojtën VII.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3, në masën 2% të vlerës së përlogaritur të kontratës në një nga format e parashikuara në ligjin nr.162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" konform nenit 83, perkatesisht në vlerën prej 80 000 leke

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (shtojça 8 e vetedeklarimit)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare. Vërtetim për xhiron vjetore të tre viteve të fundit (2020, 2021 dhe 2022) **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës** të procedurës së prokurimit, ku vlera e xhirit për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39% i vlerës së fondit limit, të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Gjithashtu vendosja e kritereve në reference është bërë që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhirit vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 19 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik dhe/ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar, me qëllim për të treguar se operatori ekonomik ka eksperiencë të suksesshme në një fushë të tillë. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve per procedurën e hapur te thjeshtuar eshte percaktuar se vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së furnizimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimeve bazuar në natyrën dhe permasat e kontratës, specifikimet teknike, grafikun e levrimit të mallit, gjykon që pjesë e kritereve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia gjykon vendosjen e kritereve si vijon:

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori të autorizuar për mallrat e kerkuara. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori duhet të provohet lidhja midis prodhuesit dhe distributorit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna

te plota te prodhuesit si: tel, fax, email, website, kjo e nevojshme per AK ne rast verifikimi nga ana e tij.

- a) Operatori ekonomik duhet te paraqes nje deklarate me ane te se ciles merr persier te kryeje sherbimin e transportit deri ne adresen e AK.
- b) Operatori ekonomik duhet te paraqesi deklartara mbi origjinen e mallit (firma prodhuese dhe vendi i prodhimit).
- c) Operatori ekonomik duhet te paraqes deklarate mbi skadencen e mallit objekt kontrate . Materialet e laboratorit duhet te kene daten e skadences jo me pak se 18 muaj nga data e furnizimit te mallit ne magazinën e KSU –se.

Argumentimi: Në bazë, të nenit 77 pika 1 e Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se:

Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6, 8 , neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit PublikOE të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si

- a) fotografitë apo katalogët teknike; dhe/ose
- b) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

Bazuar sa me siper, AK duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantojë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi. Për autoritetin është e rëndësishme që të sigurohet “mall” sipas standarteve të kërkuara, specifikimeve teknike, e gjithashtu dokumentacioni i kërkuar për tu paraqitur është i parashikuar dhe brenda kuadrit ligjor të sipërcituar. Kuadri ligjor ne reference I jep mundësinë autoriteteve kontraktorë t’u kërkojnë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike. Kriteret per kualifikim lidhur me autorizimin e prodhuesit duke përfshirë në mënyrë alternative edhe autorizimin nga distributori i autorizuar nga prodhuesi me kushtin që në cdo rast të vërtetohet me dokumentacion konkret lidhja e distributorit të autorizuar me prodhuesin pasi ky dokumentacion i paraqitur në mënyrë të plotë do të vërtetonte dhe dëshmonte njësoj origjinën e mallit, katalogu, mostrat, deklaratat, njesia e prokurimit i gjykon se vendosja e tyre është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës objekt prokurimi dhe jodiskriminuese. Persa I perket deklarates per mjet per transportin e mallit, ky kriter kërkohet që

operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme :

- Certifikatën e cilësisë së punimeve **ISO 9001-2015** (e vlefshme)/ose/ ekuivalent. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikata si më sipër duhet të paraqitet origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Me anën e këtij kriteri synohet që të njihet aftësia e operatorit për të ofruar punë që plotësojnë kërkesat e Autoritetit Kontraktor, si dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore sipas standardeve më të larta. Ky standart u vendos në bazë të nenit 79, pika 1 e tij, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, e nenit 40, dhe 44, pikës 3 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kriter në përputhje me natyrën e objektit të kontratës. Autoriteti kontraktor vlerëson këtë kriter si të nevojshëm për ekzekutimin me sukses të kontratës. *Certifikimet ISO janë certifikata që iu akordohen kompanive të cilat manifestojnë menaxhim të lartë bazuar në standardet ndërkombëtare të vendosura në përputhje me legjisacionin ndërkombëtar që e rregullon këtë fushë, për të garantuar mallra me cilësi dhe në përputhje me specifikimet teknike pjesë e dokumentave të tenderit. Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë, kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilësor të tij.*

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për objektin e prokurimit, që do të përfshihen në specifikimet teknike në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 1,2 44, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik...

- 1. Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimin të mallrave.*

2. Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Bazuar në procesverbalin e të hartuar nga grupi i punës i ngritur për këto qëllime, ky grup në hartimin e specifikimeve teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të mallit, ka marrë në konsideratë faktin se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat shërbimeve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës.

AK në hartimin e specifikimeve teknike ka në vlerësim se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit (parashikuar nga neni 2 gërma “c”, “ç”, “d” “dh” e LPP-së) janë ato të transparencës dhe trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. Specifikimet teknike të hartuara ofrojnë akses të barabartë për ofertuesit dhe nuk duhet të kenë efektin e krijimit të pengesave të pajustificuara për hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këto kombëtar apo ndërkombëtar. Në hartimin e specifikimeve teknike AK ka shmangur çdo formë diskriminimi qoftë ato të dukshme qoftë ato të fshehta të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast specifikimet teknike nuk janë hartuar në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/mall/shërbim që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm.

Në hartimin e specifikimeve teknike AK ka mbajtur në vëmendje faktin se specifikimet teknike mbështetur në nenin 44 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, I ndryshuar.

Në vijimësi, AK ka zbatuar me përpikmëri dispozitën e mësipërme të LPP-së në hartimin e specifikimeve teknike. Me anë të specifikimeve teknike mundësohet një konkurrencë e drejtë e hapur dhe gjithëpërfshirëse të barabartë dhe jo diskriminuese për të gjithë operatorët ekonomikë si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Në përfundim AK ka vendosur kritere nisur nga natyra

dhe permasat e kontrates, ne funksion te realizimit me sukses te saj, duke pershkruar minimumin e elementeve teknike si edhe ka vendosur termin ekuivalent ne ato raste kur nuk ekziston nje menyre e mjaftueshme, e sakte apo e kuptueshme, e pershkrimit te kerkesave, me kusht qe fjalët “ose ekuivalent” te perfshihen detyrimisht ne keto specifikime.

Specifikimet teknike jane hartuar nga grupi i punes i ngritur me urdherin e titullarit te AK ne perputhje me qellimin e realizimit te sherbimit me qellim arritjen e eficenses dhe efikasitetit te ketij sherbimi, duke garantuar trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per operatorët ekonomike, si vijon:

1. Materialet laboratorike duhet te jene daten e skadences jo me pak se 18 muaj nga data e furnizimit te mallit ne magazinën e KSU –se.
2. Te gjithe materialet te jene te percaktuar: emrin e percaktuar nga firma prodhuese (emrin komercial) dhe emrin kimik te produktit, njesine e matjes, firmen prodhuese dhe shtetin. Te jene prodhime CE. AK lejon dhe paraqitjen e cerifikikates FDA si nje dokument i cili konfirmon konformitetin e paisjeve /artikujve mjeksore objekt prokurimi .
3. Data e skadences (per ato artikuj qe kane date skadence) te jete ne kuti dhe çdo njesi baze .
4. Ne oferte te jete i percaktuar lloji i ambalazhit dhe materialet te jene ambalazhin origjinal nga prodhuesi dhe te mbyllur.
5. Produkti ne brendesi te ambalazhit te koorespodoje me te dhenat e ambalazhit, sipas kerkesave te KSU –se.
6. Te jene bashkengjitur instruksione perdorimi per secilin material.
7. Me sipercifikimet teknike te detajuar per cdo artikull sipas listes bashkelidhur sasise se mallit.

Grupi i punës për përlogaritjen e fondit limit, pas finalizimit te nevojave/ specifikimet teknike të hartuara bazuar në nenet 34 dhe 36 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenet 12, 13 76 të VKM Nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, filloj punën për përlogaritjen e vlerës limit të kontratës objekt prokurimi, konkretisht si vijon:

Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit:

Bazuar në nenin 76 të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në përlogaritjen e vlerës së fondit limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet ti referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- a) *çmimet e botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe*
- b) *studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe*
- c) *çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
- ç) *çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.*

Grupi i Punës, duke marrë në konsideratë rastin në fjalë, natyrën/specifikat e këtij prokurimi, legjislacionin dhe rregullat e tregut për këtë blerje, ka organizuar punën dhe ka ndërmarrë hapa konkret për secilën nga alternativat e përcaktuara në nenin 76 të VKM 285/2021 për llogaritjen e vlerës limit të kontratës (fondit limit), me qëllimin që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. Lidhur me këtë proces, grupi i punës ka argumentuar dhe dokumentuar referuar materialeve , administruar si pjese e dosjes se prokurimit.

Pas hartimit dhe miratimit të dokumenteve të tenderit dhe kriterëve për kualifikim Njësia e prokurimit, në zbatim të pikës 3, të manualit teknik “*Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike*”, miratuar me udhëzimin nr. 07, datë 30.7.2021 të APP, autorizoi znj. V.V për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për procedurën e prokurimit per objektin ne reference si dhe në zbatim të nenit 42, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, vendosi si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave:

Njësia e Hartimit të Dokumentave Standarde